

Instituti për Studime të Avancuara GAP

Letërnjoftimi i Komunës së Lipjanit 2012

Tetor, 2012

“Letërnjoftimi i Komunave” është projekt i Institutit GAP i cili vlerëson qeverisjen komunale dy vite pas zgjedhjeve lokale të 2009. Ky projekt është implementuar në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Qendrën e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC). Rezultatet e hulumtimeve të GAP për qeverisjen komunale janë debatuar me kryetarët e komunave në emisionet “Jeta në Kosovë”.

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive.....	3
1. Problemet në Komunën e Lipjanit.....	6
2. Performanca buxhetore e Lipjanit	7
3. Investimet kapitale.....	11
4. Aktivitetet e Prokurimit Publik.....	12
5. Administrata në Komunën e Lipjanit	13
6. Arsimi në Komunën e Lipjanit	14
7. Shëndetësia në Komunën e Lipjanit	15
8. Transparenca.....	16
9. Përmbushja e premtimeve zgjedhore 2009.....	19
10. Burimet.....	23

Përmbledhje ekzekutive

Komuna e Lipjanit udhëhiqet nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK). Kryetari aktual i kësaj komune z. Shukri Buja, po e përmbyll vitin e tretë në mandatin e dytë në si kryetar komune. Në vitin 2007 z. Buja ka nisur mandatin e parë, ndërsa mandatin e dytë e ka fituar në janar 2010 pas balotazhit me kundër kandidatin nga LDK z.Imri Ahmeti. Raundi i parë i këtyre zgjedhjeve ishte karakterizuar me parregullsi të shumta, me ç'rast Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) e pati shpallur të pavlefshëm procesin zgjedhor në raundin e parë të 19 dhjetorit 2009, duke organizuar zgjedhje të reja për këtë komunë më 13 janar 2010. Hyrja në balotazh e shtyu PDK-në që të bëjë marrëveshje para zgjedhore për qeverisjen e Lipjanit me Aleancën Kosova e Re (AKR), ndërsa LDK mori mbështetjen e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Partisë Social Demokrate të Kosovës (PSDK). Pas zhvillimit të balotazhit, kandidati i PDK z. Shukri Buja fitoi 53.1% të votave, ndërsa kundër kandidati i tij nga LDK z. Imri Ahmeti 46.3%, përderisa 0.6% e votave janë shpallur të pavlefshme.

PDK në Kuvendin Komunal të Lipjanit nuk e ka shumicën absolute. Nga 31 asambleistë, 12 janë nga PDK, nëntë nga LDK, katër nga AKR, dy nga LDD, dy nga AAK, një nga PSDK dhe një i pavarur, i cili në kohën e zgjedhjeve ka qenë kandidat i subjektit politik ORA. Por, PDK shumicën absolute e ka siguruar në Kuvend nga koalicioni me AKR dhe LDD, të cilat së bashku numërojnë 18 asambleistë duke rreshtuar kështu LDK, AAK dhe PSDK në parti opozitare në Kuvendin e Lipjanit.

Kjo komunë bashkë-qeveriset mes PDK, AKR dhe LDD. Nga 13 drejtori sa ka komuna e Lipjanit, dy udhëhiqen nga AKR dhe dy nga LDD. AKR udhëheq më Drejtorinë e Shëndetësisë dhe më Drejtorinë e Bujqësisë, ndërsa LDD udhëheq më Drejtorinë e Administratës dhe më Drejtorinë për Ekonomi dhe Zhvillim. Ndërsa nëntë drejtori tjera udhëhiqen nga PDK (Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm, Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe pronë, Drejtoria për Arsimit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Prokurim, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Inspektoratit, Drejtoria për Mbrojtje Civile dhe Shpëtim). Sipas Ligjit për Vetëqeverisje lokale, çdo komunë ka të drejtë për një nënkryetar. Komuna mund të ketë dy nënkryetar vetëm në rastet kur në atë komunë banon një komunitet pakicë i cili përbën së paku 10% të popullsisë.¹ Në regjistrimin e fundit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, në komunë të Lipjanit rezulton të banojnë 3.111 qytetar që u përkasin komunitetit jo shumicë, ndërsa numri i përgjithshëm i banorëve në këtë komunë ka dal të jetë 57.605 banorë.

Pas decentralizimit dhe evidentimeve nga regjistrimi i popullsisë rezulton se komuniteti pakicë në Komunën e Lipjanit përbën më pak se 4% të popullsisë. Kështu,

¹ Kuvendi i Kosovës. Ligji për Vetëqeverisje Lokale. Neni 60 dhe 61 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Burimi: http://kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L040_al.pdf

Komuna e Lipjanit ka bërë shpërfillje ligjore kur ka emëruar dy nënkryetar komune dhe të dy nënkryetarët janë nga komuniteti shumicë. Njëri nënkryetar është nga PDK (Florent Hoxha) dhe tjetri nga AKR (Banush Bytyqi).

Statuti i komunës së Lipjanit parasheh funksionimin e 10 drejtorive, kurse në realitet Komuna ka 13 drejtori.² Pas zgjedhjeve lokale të 2010, Kuvendi komunal ka votuar për rritjen e numrit të drejtorive në 13, por pa e ndryshuar Statutin. Në këtë rast është shkelur Statuti i komunës, ngase Kuvendi komunal me rastin e vendimit të rritjes së numrit të drejtorive është dashtë të marr vendim edhe për ndryshimin e statutit të komunës. Një nga arsyet se përse nuk është bërë kjo mund të jetë se për ndryshimin e Statutit nevojiten 2/3 e votave të Kuvendit, numër ky të cilin partitë në koalicion nuk e kanë pasur në Kuvend.³

Komuna e Lipjanit kategorizohet në mesin e komunave me më së shumti shpenzime të parasë publike për darka dhe dreka zyrtare, për udhëtime zyrtare, telefon, mëditje, derivate, reprezentacion e kështu me radhë. Kjo komunë në dy vitet e fundit është karakterizuar edhe me nivel të konsiderueshëm të borxhit publik, përkatësisht faturave të papaguara. Në 2011 shuma e përgjithshëm e faturave të papaguara nga kjo komunë ka qenë 326.000 euro, përderisa një vit më herët (2010) shkalla e borxhit që ka pasur kjo komunë ka qenë trefishë më e lartë, saktësisht 1.544.300 euro.

Në disa raste autoritetet lokale nuk janë treguar të kujdesshme në vlerësimin dhe mbrojtjen e zonave me interes të përgjithshëm, siç është atraksioni turistik Shpella e Gadimes. Mbi këtë shpellë, komuna e Lipjanit ka lejuar ndërtimin e një impianti për nxjerrjen e ujit i cili e ka dëmtuar zhvillimin e kristaleve brenda shpallës dhe njëherazi ia ka zbehur pamjen shpellës. Ky degradim i Shpellës së Gadimes është bërë edhe pas vendimit të Qeverisë së Kosovës (vendimi 4/57 i datës 13 mars 2009) me anë të të cilit Shpella e Gadimes vihet nën mbrojtje, përkatësisht vlerësohet në kategorinë e monumenteve me rëndësi të veçantë.⁴ Neglizhenca e autoriteteve vërehet edhe të rasti i shkollës së mesme bujqësore. Në shkollën "Adem Gllavica" para tri viteve janë investuar në riparimin dhe modernizimin e saj 3 milionë euro nga një organizatë norvegjeze. Gjendja e saj aktualisht është jo e mirë ku mungojnë karriget, bankat, dyert dhe dritaret janë përgjithësisht të dëmtuara si dhe tualetet e brendshme janë jo funksionale.

² Komuna e Lipjanit. Statuti i Komunës së Lipjanit. Neni 47 i Statutit të Komunës së Lipjanit. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/lipjan/getattachment/Municipality/Statut/Statuti-i-aprovuar,-me-26-09-2008-pdf.pdf.aspx>

³ Në seancën e 8 korrikut 2011 ekzekutivi i Komunës ka paraqitur një propozim në Kuvend të Lipjanit që të ndryshohet Statuti, ku është paraparë që me statut të ri të mos figuroj numri i drejtorive, por KK nuk e ka aprovuar këtë propozim.

⁴ Qeveria e Kosovës, vendimi 4/57, 13 mars 2009. Burimi: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_57_t_te_Qeverisë_2009.pdf

Zonat urbane të Lipjanit gjatë dy viteve të kaluara janë mbërthyer nga nisja e ndërtimeve të larta banesore. Por, shkalla relativisht e lartë e investimeve private në lëmin e ndërtimeve nuk është manifestuar edhe me respektimin e kritereve ligjore për ndërtim. Kriteret ligjore kanë paraparë së ndërtimet mund të bëhen duke shfrytëzuar 60% të hapësirës për ndërtim, ndërsa pjesa tjetër prej 40% duhet të dedikohet për gjelbërim, parking veturash dhe kënde rekreative. Në asnjë objekt shumëkatësh në Lipjan nuk është respektuar dhe zbatuar ky kriter. Të gjitha ndërtimet kanë shfrytëzuar deri në 100% të hapësirës për ndërtim. Po ashtu janë të shpeshta rastet kur hasën ndërtime afër hapësirave kryesore të këmbësoreve, pa pasur masa mbrojtëse për kalimtarët apo edhe për vetë punëtorët që angazhohen në ato ndërtime.

1. Problemet në Komunën e Lipjanit

Ndotja dhe kontaminimi i rrjedhjes së lumit Sitnica, mungesa e ujit të pijes nëpër fshatra, mungesa e hapësira të gjelbëruara dhe të rekreacionit brenda qytetit, ndërtimet pa kriter, mos qëndrueshmëria e investimeve në infrastrukturë, krijimi i deponive të egra mbeturinash në fshatra si dhe mos sinjalizimi i vendbanimeve, llogariten si probleme madhore për komunën e Lipjanit.

Hedhja e mbeturinave në rrjedhën e lumit Sitnica dhe derdhja e kanalizimeve të fshatrave në këtë lum, vazhdon të mbetet njëra ndër problemet me akute për qytetarët e Komunës së Lipjanit. Autoritetet lokale nuk kanë ndërmarr asnjëherë masa në këtë drejtim dhe nuk ka pasur ndonjë plan konkret për rregullimin e shtratit të këtij lumi. Të dhënat nga terreni dëshmojnë se nuk janë të pakta rastet kur edhe kompanitë private të cilat kryejnë punë publike e shfrytëzojnë rrjedhjen e lumit për t'i hedhur dhjetëra tonë material dhe mbeturina tjera të ngurta. E gjithë kjo kalon e pandëshkuar nga ana e zyrtarëve kompetent të komunës së Lipjanit. Kundërmimi i erërave dhe përhapja e insekteve nga lumi Sitnica vështirëson jetën e përditshme të qytetarëve. Një pjesë e madhe e shtratit të lumit është uzurpuar nga ana qytetarëve dhe janë hasur edhe raste kur hapësira e shtratit të lumit është shfrytëzuar për ndërtim nga ana e qytetarëve dhe kompanive private.

Ndonëse territori i komunës së Lipjanit është i njohur për burime të shumta të ujit, fshatrat e kësaj ane kryesisht ballafaqohen me reduktime të shpeshtaekstreme të ujit të pijes, veçmas gjatë sezonit të verës. Kjo mungesë është më shumë për shkak të kapacitetit të dobët të mekanizimit të pompimit, se sa për shkak të mungesës së ujit. Dëshmi ilustruese në këtë drejtim është marr fshati Janjevë dhe fshati Rufc i vjetër. Fshati Janjevë që nga gjysma e muajit maj të vitit 2012 pothuajse asnjëherë nuk ka pasur ujë të pijes, ndërsa në fshatin Rufc i vjetër në 90% të kohës ka munguar uji.

Mungesa e vendeve të gjelbëruara dhe rekreacionit në qytetin e Lipjanit vlerësohet si problem me të cilin ballafaqohen qytetarët e kësaj ane. Autoritetet komunale kanë arritur gjatë dy viteve të kaluara ta zbusin problemin nga mungesa e parkingjeve për vetura, por akoma kjo nuk mund të thuhet edhe për krijimin e vendeve të mjaftueshme të gjelbërimit dhe rekreacionit. Ato pak vende ku është investuar në këtë drejtim, ka munguar një përkujdesje e vazhdueshme në mirëmbajtjen e tyre dhe kjo ka bërë që ato vende t'i ekspozohen dëmtimit sistematik.

Ndërtimi i banesave kolektive ka nxjerr në pah problemin e mungesës së gjelbërimit para ndërtesave, mungesës së shkallëve të sigurisë, mungesën e këndeve për fëmijë. Përveç kësaj, këto ndërtime vlerësohen se nuk kanë ndikuar pozitivisht në pamjen e qytetit, ngase janë bërë pa ndonjë harmonizim urbanistik dhe teknik.

Shkalla e investimeve publike, përgjithësisht vlerësohet e kënaqshme në këtë komunë, por cilësia e punimeve dhe qëndrueshmëria e tyre nuk është në nivel të duhur. Nuk

janë të pakta rastet kur pak ditë pas përfundimit të punimeve në ndonjë rrugë apo objekt të hasen qarje dhe dëmtime serioze s'i rezultat i materialit të dobët të përdorur apo edhe nga neglizhenca dhe papërgjegjësia e kryerjes së punëve. Shembull për këtë shërben rruga në relacionin për fshatin Rufc.

Komuna e Lipjanit posedon edhe resurse të rëndësishme natyrore dhe të trashëgimisë kulturore. Është e njohur shpella e Gadimes dhe po ashtu shtëpitë e vjetra dhe me rendësi në fshatin e Janjeves, si shtëpia e At Stefan Gjeqovit. Komuna e Lipjanit në muajin Qershor të këtij viti (2012) ka shpallur Janjeven zonë të trashëgimisë kulturore. Por, në Janjeve hasen deponi mbeturinash, përroska ku derdhen kanalizimet dhe njëherazi asnjë shtëpi duke përfshi edhe atë të At Stefan Gjeqovit nuk është e sinjalizuar për të treguar rëndësinë e saj. Sinjalizim nuk haset as në rrugët që qojnë tek Shpella e Gadimes.

2. Performanca buxhetore e Komunës së Lipjanit

Komuna e Lipjanit ka arritur progres të lehtë në rritjen e të hyrave komunale, por sipas raportit të Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2011, Komuna nuk mban një regjistër të plotë të të hyrave komunale dhe po ashtu sipas këtij raporti komuna e Lipjanit nuk e ka të precizuar listën e bizneseve aktive dhe jo aktive, faktor ky që ndikon në shkallën e të hyrave komunale, ngase disa biznese mund të mos tatimohen, ndërsa disa të tjera edhe për kundër shuarjes së veprimtarisë mund të ngarkohen me tatime.

Tabela nr.1: Shkalla e të hyrave komunale

VITI	2011	2010	2009
Shuma (Euro)	1.570.000	1.487.000	1.359.000

Nga tabela e mësipërme vërehet së dallimi mes të hyrave nga viti 2011 krahasuar me atë 2010, dallon për 83.000 euro më shumë në vitin e fundit.

Tabela nr.2: Buxheti i përgjithshëm i Komunës së Lipjanit për 2011

Kategoria	Shuma (Euro)
Investime kapitale	4.113.220,36
Mallra dhe shërbime	752.815,17
Subvencione dhe transfere	88.273
Shpenzime komunale	130.708

Paga dhe mëditje	6.580.682,25
Totali	11.448.907,59

Komuna e Lipjanit ka një trend relativisht të lartë të shpenzimit të parëse publike në linjën e buxhetit për mallra dhe shërbime. Nga të dhënat e mësipërme rezulton se në këtë kategori komuna e Lipjanit gjatë një viti ka në dispozicion 752.815 euro, ndërsa për vitin 2012 janë të parapara afro 800.000 në këtë linjë të buxhetit.

Zyra e Kryetarit në raportin e shpenzimeve të buxhetit për vitin 2011 ka të precizuara se për dreka e darka zyrtare ka shpenzuar 4.666 euro. Sipas po këtij raporti, Drejtoria e Inspektionit ka shpenzuar gati dyfish më shumë se Kryetari për dreka dhe darka, gjithsej 8.851 euro. Po ashtu edhe shpenzimet në telefon janë të përafërta në mes të Zyrës së Kryetarit dhe Drejtorisë së Inspektionit. Kryetari ka shpenzuar për telefon 2.721 euro kurse Drejtoria e Inspektionit 1.970 euro. Një element tjetër domethënës në këtë krahasim del të jetë edhe shpenzimi për udhëtimet jashtë vendit dhe mëditjet e marra. Kryetari për udhëtime dhe mëditje ka shpenzuar 1.842 euro, ndërsa Drejtoria e Inspektionit 3.591 euro.⁵ Ndërsa shpenzime e të gjithë dikastereve të Komunës së Lipjanit për dreka dhe darka zyrtare rezultojnë 23.864 euro. Ndërsa për furnizimin e komunës me ushqim dhe pije, kategori kjo që del jashtë shpenzimeve për dreka dhe darka, janë shpenzuar 19.748 euro.⁶

Në bazë të raportit vjetor financiar të komunës së Lipjanit rezulton se ky institucion vetëm brenda vitit 2011 për udhëtimet zyrtare brenda vendit ka shpenzuar 19.179 euro. Për mëditjet e udhëtimit jashtë vendit janë dhenë 6.506 euro. Për akomodim të udhëtimit jashtë vendit 2.896 euro. Shpenzime tjera të udhëtimit jashtë vendit 4.045 euro.

Për telefon komuna e Lipjanit ka shpenzuar në tërësi 16.014 euro, prej tyre 13.471 euro në telefon mobil. Për riparimin e automjeteve zyrtare të komunës janë dhenë 13.752 euro.⁷

Brenda vitit 2011 për derivate komuna ka shpenzuar 159.000 euro. Prej tyre karburant për vetura 67.299 euro, gjenerator 23.075 euro, naftë për ngrohje 69.083 euro.⁸

Shifra për blerjen e naftës për ngrohje rezulton e përafërt me shifrën për blerjen e druve për ngrohjen e shkollave. 68.362 euro rezultojnë të shpenzuara për blerjen e druve gjatë 2011, ndërsa 40.820 eurove për blerjen e thëngjillit, pra vetëm për blerjen e druve dhe thëngjillit rezultojnë të shpenzuara 109.000 euro.⁹

⁵ Komuna e Lipjanit. Raporti i buxhetit dhe shpenzimeve janar –dhjetor 2011

⁶ Komuna e Lipjanit. Raporti i buxhetit dhe shpenzimeve janar –dhjetor 2011

⁷ Komuna e Lipjanit. Raporti i buxhetit dhe shpenzimeve janar –dhjetor 2011

⁸ Komuna e Lipjanit. Raporti i buxhetit dhe shpenzimeve janar –dhjetor 2011

⁹ Komuna e Lipjanit. Raporti i buxhetit dhe shpenzimeve janar –dhjetor 2011

Në bazë të raportit zyrtar financiar të komunës së Lipjanit shihet se Zyra e Kryetarit ka dhenë për individ të caktuar 27.360 euro. Në raportin financiar nuk ceket për rastet, por vetëm ceket për përfituesit individual. Në Kuvend komunal nuk ka pasur asnjë raport nga ekzekutivi se kush ka përfituar mjetet nga komuna, mbi çfarë arsyes janë dhanë këto mjete dhe cili ka qenë përfitimi i komunës nga dhënia e këtyre mjeteve.¹⁰

Tabela nr.3: Shpenzimet në disa kategori tjera gjatë vitit 2011 në linjën e mallrave dhe shërbimeve nga Komuna e Lipjanit

Kategoria	Shuma (euro)
Shërbime arsimore dhe trajnuese	3.232
Shërbimet kontraktuese tjera ¹¹	112.846,49
Blerja e mobileve	11.033
Furnizim për zyre	65.729,12
Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	23.752,46
Mirëmbajtja e teknologjisë informative	4.263,98
Reklama dhe konkurse	2.103,90
Botime dhe publikime	10.809
Shpenzim për informim publik	1.196
Shpenzime të energjisë elektrike	83.527,15
Shpenzimet e ujit	18.910,15
Shpenzimet për mbeturina	11.652,39

Tabela nr.4: Shpenzimet në disa kategori të mallrave dhe shërbimeve në 2010 nga Komuna e Lipjanit

Kategoria	Shuma (euro)
Shpenzimet e udhëtimit brenda vendit	17.000
Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit	8.000
Mëditje për udhëtime jashtë vendit	5.000
Shpenzime në telefonin 'vala'	8.000
Shpenzimet në trajnime	12.000
Shërbimet kontraktuese tjera ¹²	91.000
Naftë për ngrohje qendrore	51.000
Blerje të thëngjillit	21.000
Blerje të druve	46.000

¹⁰ Komuna e Lipjanit. Raporti i buxhetit dhe shpenzimeve janar –dhjetor 2011

¹¹ Nuk specifikohet në raport lloji i shërbimeve.

¹² Nuk specifikohet në raport lloji i shërbimeve.

Derivate për gjenerator	14.000
Karburante për vetura	61.000
Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	24.000
Botime dhe publikime	27.000
Dreka Zyrtare	30.000
Ushqim dhe pije - jashtë drekave zyrtare	28.000
Furnizim për zyre	60.000
Blerje të mobileve	14.000

Krahasimi i shpenzimeve në dreka zyrtare mes vitit 2010 dhe 2011 rezulton së në vitin 2010 komuna e Lipjanit ka shpenzuar afërsisht shtatë mijë euro me shumë së një vit më vonë (2011).¹³ Disa nga shpenzimet për dreka dhe darka zyrtare në 2010 janë bërë si festimi i përvjetorit të dytë të pavarësisë së Kosovës, solemnitet ky i mbajtur në restorantin “Auto-toni”, darkë e cila i ka kushtuar buxhetit të komunës 7 mijë euro. Me parat e komunës së Lipjanit janë akomoduar dhe furnizuar me ushqim dhe pije delegacioni zyrtar nga një komunë Turke e quajtur Buxha i cili buxhetit të komunës i ka kushtuar 9.000 euro. Darkë solemne është organizuar edhe me rastin e përfundimit të vitit buxhetor (fund të 2010) darkë kjo në vlerë prej 2,495 euro. Drekë për ditën e ashkalinjëve në vlerë prej 800 eurove, si dhe furnizim me ushqim dhe pije për delegacionin nga Shqipëria (Fushe Arrëz), të cilët në Kosovë kanë qenë për ekskursion, në vlere prej 855 eurove.

Sipas raportit të Auditorit të Përgjithshëm i cili i referohet periudhës së vitit 2011, kontrollet e papërshtatshme dhe të pamjaftueshme në lidhje me të ardhurat dhe në lidhje me programet dhe sistemit të faturimit rrisin rrezikun e manipulimit të shifrave dhe keqpërdorimit të informatave. Një sistem i tillë mund të çojë në faturim jo të plotë. Auditori ka gjetur se të ardhurat e mbledhura në shkollën “Adem Gllavica” nuk janë regjistruar në sistemin financiar të komunës dhe nuk ishin transferuar në llogarinë e vetme të thesarit, ku vlera e këtyre mjeteve përafërsisht sillet në 30.000 euro.¹⁴ Po sipas Auditorit, komuna ka shpronësuar 41.704 metra katror të pasurisë së tij të paluajtshme pas një kërkesë për shpronësim nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, për zgjerimin e aeroportit ekzistues në një shumë totale prej 144.350 euro. Auditori edhe përkundër kërkesës nuk është pajisur me dokumente të mjaftueshme lidhur me një eksproprijimin të tillë, dokument si raporti i vlerësimit të pronës së eksproprijuar, dokumentacioni për transferimin e pronës, kontrata ndërmjet palëve, shpallja publike për eksproprijimin e pronës publike etj., ashtu siç kërkohet nga Udhëzimi Administrativ nr 21/2009 për Menaxhimin e Pronës publike.

¹³ Në vitin 2010 shpenzime Komuna e Lipjanit për dreka dhe darka ka pasur 30.000 euro, ndërsa në 2011 - 23.847 euro.

¹⁴ Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti I Auditorit për Komunen e Lipjanit për vitin 2011. Burimi: http://www.oag-rks.org/repository/docs/Lipjan_31_12_2011_Final_alb_616502.pdf

Auditori konstaton së komuna e Lipjanit i ka dhënë 16. 000 euro klubit të futbollit “Ulpiana” pa ndonjë marrëveshjeve të nënshkruar, ndërsa në vendim nuk është kërkuar që përfituesi duhet t’i raportojë komunës për mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve si dhe nuk ka pasur monitorim nga komuna për mënyrën e shpenzimit të këtyre mjeteve.

3. Investimet kapitale

Investimet kapitale në komunën e Lipjanit gjatë dy viteve të kaluara (2010 -2011) kanë pasur një shtrirje të gjerë duke përfshirë rregullimin dhe asfaltimin e rrugëve, rrjetit të kanalizimit, ujësjellësit dhe objekteve tjera përcjellëse në sferën e arsimit dhe atë të shëndetësisë. Shuma e përgjithshme e mjeteve që ka Komuna e Lipjanit në dispozicion për investime kapitale gjatë një viti sillet rreth 4.2 milionë euro.

Tabela nr.5: Disa nga investimet kapitale të Komunës së Lipjanit të realizuara gjate vitit 2011

Projektet kryesore të realizuara gjatë 2011	Shuma (euro)
Asfaltimi i Rrugës Rubovc-LLugaxhi	134.155,24
Asfaltimi i rrugës në fshatin Llugë	85.655,91
Asfaltimi i rrugës në Kleqkë	70.095
Asfaltimi i rrugës Brus ‘Faza -III-’	122.752,05
Asfaltimi i rrugës Tërbufc	291.953,45
Asfaltim i rrugës “Avdi Kelmendi”	50.846,35
Asfaltim i rrugës “Qamil Olluri”	54.832,55
Asfaltim i rrugës “Haxhi Kleqka”	184.213,00
Asfaltimi i rrugës “Marevc”	87.241,00
Asfaltimi i rrugëve në relacionin Shalë-Krojmir	684.499,72
Kanalizimi në Ribar	36.571,56
Kanalizimi në Shalë ‘Faza e -II-’	198.441,00
Kanalizimi në Topliqan ‘Faza e -II-’	125.440,22
Kanalizimi Banullë-Gllogofc ‘Faza -II-’	262.727,87
Kanalizimi në Gadime ‘Faza e parë’	431.589,84
Kanalizimi në Sllovi	197.262,03
Kanalizimi në relacionin Vrellë-Medvec	853.696
Rrjeti i ujësjellësit në fshatin Gumnasellë	31.350
Rrjeti i ujësjellsit në fshatin Qallapek	83.600

Gypi Kryesor –Banulle-Marevc ¹⁵	600.000
Rezervuari Gadime (Kodra e Murturit ¹⁶)	180.000

Tabela nr.6: Disa nga investimet kapitale të Komunës së Lipjanit të realizuara gjatë vitit 2010

Projektet kryesore të realizuara gjatë 2010	Shuma (Euro)
Asfaltimi i rrugës “Babush i Muhaxhirëve”	239.629,69
Asfaltimi i rrugës në relacionin Banull – Shalë	93.529,40
Asfaltimi i rruges për në Blinaj	110.147,30
Asfaltimi i rrugës për në fshatin Brus	35.532
Instalimi i kanalizimit në Livazhd	73.630
Shtrirja e rrjetit të kanalizimit në Shalë	239.218
Rrjeti i kanalizimit në relacionin Ribar - Zhllakuqa	175.839,57
Rrjeti i kanalizimit në Podurovc	95.694
Faza e parë e instalimit të rrjetit të kanalizimit në Sllovi	91.834
Asfaltimi i rrugës në Grack të vogel	188.888
Asfaltimi i rrugës në Kojskë	130.885,10
Asfaltimi i rrugës Rufc i vjetër	466.612,27
Asfaltimi i rrugës “Avdi Kelmendi”	50.846,35

4. Aktivitetet e Prokurimit Publik 2010 - 2011

Komuna e Lipjanit është vetëm njëra nga dy komunat (krahas Vushtrrisë) e cila Zyrën e Prokurimit e ka avancuar në nivel të drejtorisë së veçantë për prokurim. Në këtë drejtori janë gjithsejtë gjashtë persona të punësuar dhe krahas ekzistimit të pozitës së drejtorit të prokurimit është funksionale edhe pozita e shefit të prokurimit. Për dy vite (2010-2011) komuna e Lipjanit ka lidhur 191 kontrata nëpërmjet procedurave të prokurimit publik, me një vlerë të kontratave mbi 9 milionë euro.

Tabela nr.7: Kontratat e Prokurimit në Komunën e Lipjanit
2010-2011

Viti	Nr. i kontratave	Vlera e kontratave
2010	104	4.562.256,33
2011	87	4.714.701,32
Totali	191	9.276.957,65

Burimi: KRPP Raporti për 2010 dhe 2011

¹⁵ Investimi është bërë nga organizata Gjermane - CDF

¹⁶ Investimi është bërë nga organizata Gjermane - CDF

Auditorit i Përgjithshëm në raportin e vitit 2011 ka gjetur disa anomali në sferën e prokurimit publik në komunën e Lipjanit, anomali këto që Auditori i ka kategorizuar me rrezikshmëri të lartë.¹⁷ 8.730 euro. Për më tepër, njoftimet për ofertuesit e pasuksesshëm nuk kemi mundur t'i gjejmë në dosjet e tenderit, ashtu si është e kërkuar me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

5. Administrata e Komunës së Lipjanit

Numri i përgjithshëm i të punësuarve në Komunën e Lipjanit është 204 persona duke mos përfshirë këtu edhe të punësuarit në sektorin e arsimit dhe në sferën e shëndetësisë. Së bashku me këta dy sektorë numri i përgjithshëm i të punësuarve në Lipjanit është 1.480 gjithsej të punësuar.

Auditorit i Përgjithshëm i vendit në raportin e fundit ka konstatuar se 31 të punësuar nga komuna e Lipjanit nuk paraqiten në listën e rregullt të pagave në sektorin e arsimit.¹⁸ Sipas po këtij raporti, 11 punonjës të tjerë nga shkolla e mesme “Adem Gllavica”, janë hequr nga lista e pagave në fund të vitit 2011 dhe janë kthyer në listë e pagave gjatë fillimit të vitit 2012. Njëherazi Auditori ka gjetur se për gjashtë pozita në sektorin e administratës nuk janë hasur dëshmi që për vendin e lirë të punës është shpallur konkurs, ashtu siç Auditori e quan shkelje të procedurave ligjore mungesën në dosjen e personelit të dëshmimeve për përvojën paraprake të punës të kandidatëve të cilët janë pranuar në punë.

Tabela nr.8: Numri i të punësuarve sipas sektorëve në Komunën e Lipjanit

Sektorët	Numri i të punësuarve
Zyra e Kryetarit ¹⁹	26
Drejtoria e Administratës	48
Drejtoria e Prokurimit	6
Drejtoria e Financave	17

¹⁷ Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i Auditorit për Komunen e Lipjanit për vitin 2011. Burimi: http://www.oag-rks.org/repository/docs/Lipjan_31_12_2011_Final_alb_616502.pdf

¹⁸ Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti I Auditorit për Komunen e Lipjanit për vitin 2011. Burimi: http://www.oag-rks.org/repository/docs/Lipjan_31_12_2011_Final_alb_616502.pdf

¹⁹ Në kuadër të Zyrës së Kryetarit funksionojnë edhe Zyra e Protokollit, Zyra për çështje Ligjore, Zyra për Komunikim me media, Zyra për Barazi Gjinore, Zyra Komunale për Kthim, Zyra e Auditorit të Brendshëm, Zyra për Integritim Evropiane, Zyra për çështje Pronësore, Zyra për Komunitete dhe Zyra e Personelit.

Drejtoria e Urbanizimit	6
Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim rural	13
Drejtoria për zhvillim ekonomik	5
Sektori i Arsimit	1.032
Drejtoria e Arsimit	7
Sektori i Shëndetësisë	231
Drejtoria e Shërbimeve publike & Zjarrfikësit	33
Drejtoria për Kulturë-Rini dhe Sport	15
Drejtoria e Shëndetësisë	6
Drejtoria e Inspektionit	12
Drejtoria për gjeodezi dhe kadastër	10
Qendra për Punë Sociale	13
Gjithsejtë	1.480

6. Arsimi në Komunën e Lipjanit

Në komunën e Lipjanit funksionojnë gjithsejtë 51 shkolla fillore (objekte shkollore), katër shkolla të mesme dhe një çerdhe. Në çerdhen e qytetit janë të sistemuar 114 fëmijë, prej tyre 73 meshkuj dhe 41 femra. Personel i angazhuar në çerdhe janë gjithsej 17, prej tyre tetë edukatore dhe nëntë veta staf ndihmës. Komuna e Lipjanit numëron edhe 929 fëmijë të inkuadruar në sistemin para-shkollor, ku 463 janë meshkuj dhe 466 janë femra.

Tabela nr.9: Numri i mësimdhënësve dhe stafi përcjellës në 51 shkollat fillore të Lipjanit:

Gjinia	Numri i mësimdhënësve	Stafi ndihmës
Femra	302	20
Meshkuj	366	138
Gjithsejtë	668	158

Në komunën e Lipjanit ekzistojnë katër shkolla të mesme të profilit gjimnaz, ekonomi dhe bujqësi.

Tabela nr.10: Numri i mësimdhënësve dhe stafi përcjellës në shkollat e mesme të Lipjanit

Gjinia	Numri i mësimdhënësve	Stafi ndihmës
Femra	54	4

Meshkuj	120	28
Gjithsejtë	174	32

Tabela nr.11: Numri total i mësimdhënëseve, nxënëseve dhe stafit ndihmës në 51 shkolla fillore dhe katër shkolla të mesme në Komunën e Lipjani

Kategoria	Numri	F	M
Mësimdhënës	842	356	486
Nxënës	14.283	6.781	7.502
Stafi ndihmës	190	24	166

Në komunën e Lipjanit gjatë dy viteve të kaluara është shënuar përparim në përmirësimin e infrastrukturës në objektet arsimore. Shkollat përgjithësisht janë gëlqerosur, janë ndërtuar shumë objekte të reja arsimit, janë ndërruar dyert dhe dritaret, janë ndërtuar salla të sporteve dhe investime ka pasur edhe në ambientet e jashtme duke u ndërtuar në disa shkolla fusha të hapura sportive si dhe janë rregulluar parqet dhe rrethojat në disa shkolla.

Tabela nr.12: Disa nga investimet gjatë 2010 -2011 në infrastrukturën e shkollave të Lipjanit:

Investimet	Shuma (euro)
Ndërtimi i objektit shkollor në fshatin Poturovc	200.000
Ndërtimi i objektit shkollor në fshatin Blinajë	129.776,40
Ndërtimi i objektit shkollor në fshatin Gadime e Ulët	130.292,40
Riparimi i objektit të shkollës fillore "Hivzi Sylejmani" në Dobrajë të Madhe	70.206,80
Furnizimi i shkollave të Komunë së Lipjanit me banka dhe karrige	76.000
Ndërtimi i objektit shkollor në Bujan	500.000
Ndërtimi i objektit shkollor në Banullë	483.684,50
Fasadimi i objektit shkollor në Babush	14.999
Meremetimi i shkolle së Dobrajes 'Faza e II'	12.994,40
Rregullimi i rrethojës në shkolle fillore në Sllovi	15.970,60
Meremetimi i shkollës fillore "Zenel Hajdini" Gadime Eperme	158.054,60
Ndërtimi i shkollës fillore "Emin Duraku" Banullë njësia Glllogovc	396.635,17
Ndërtimi i shkollës fillore "Skenderbeu" Kraishte	498.383,49

7. Shëndetësia në Komunën e Lipjanit

Në komunën e Lipjanit funksionon një Qendër Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF), katër Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) dhe gjashtë punkte shëndetësore apo ambulanca. QKMF gjendet në qendër të qytetit, ndërsa QMF janë të shpërndara, një e tillë gjendet në fshatin Gadime, pastaj në fshatin Magurë, Shalë dhe Janjevë. Punktet shëndetësore gjenden në Sllovi, Radavc, Kraishtë, Dobrajë, Banull dhe në fshatin Babush.

Totali i të punësuarve në sektorin e shëndetësisë në komunën e Lipjanit është 231 të punësuar, pjesa më e madhe prej tyre në QKMF në Lipjan.

Tabela nr.13: Numri dhe pozitat e të punësuarave në sektorin e shëndetësisë së Lipjanit

Pozitat	Numri
Mjek familjar	18
Mjek të përgjithshëm	18
Specialistë	2
Stomatolog	5
Gjinekolog	2
Pneumoftiziolog	1
Radiolog	1
Infermier	84
Mami	18
Laboranta	12
Farmacisë	3
Teknik stomatolog	7
Teknik radiolog	3
Staf ndihmës /administratë, pastrim, arkivim, vozitës.	57
Gjithsejtë	231

8. Transparenca

Zyra për Informim në komunën e Lipjanit funksionon brenda Zyrës së Kryetarit dhe ka gjithsejtë dy të punësuar. Kjo komunë mbulohet rregullisht nga mediumet e shkruara të

cilat kanë të angazhuar korrespondentë nga ky lokalitet. Cilësia dhe sasia e informatave që korrespondentë marrin nga ana e autoriteteve lokale vlerësohet përgjithësisht e kënaqshme.

Faqja zyrtare ka informata bazike në lidhje me komunën dhe zhvillimet e përditshme, por janë të pakta dokumentet zyrtare që mund të hasen në këtë ueb faqe, përjashtimisht pasqyrimin shumë të detajuar të aktiviteteve të Kryetarit të Komunës dhe agjendës së tij.

Tabela: nr14: vlerësim i përmbajtjes së ueb faqes së Komunës së Lipjanit
<http://kk.rks-gov.net/lipjan/Home.aspx>

Dokumenti	2010				2011				2012
	I	II	III	IV	I	II	III	IV	I
Raporti i Punës së Kryetarit	x	x	x	√	x	x	x	√	x
Raporti financiar (buxhetor) i Komunës	x	x	x	√	x	x	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Administratës	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Arsimit	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mir.Sociale	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Inspektionit	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Ekonomi dhe Zhvillim	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Gjeodezi dhe Kadastër	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Buxhet dhe Financa	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Mbrojtje dhe Shpëtim	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Planifikim dhe Urbanizëm	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Shërbimet Publike	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Inspektoriati	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Kulëturë, Rini dhe Sport	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Prokurim	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet dhe njoftimet e Zyrës së Prokurimit					√				
Raportet e Njesisë së Auditimit të Brendshëm					x				
Procesverbalet e Kuvendit Komunal	x				x				x
Rregulloret Komunale	Të gjitha rregulloret janë të publikuara.								
Vendimet e Kuvendit Komunal	√				√				√
Rregullorja e Punës së Kuvendit Komunal					√				
Procesverbalet e Komitetit për Politikë dhe Financa	x	x	x	x	x	x	x	x	x

Planet dhe Strategjitë e Komunës	√
----------------------------------	---

X = mungon raporti. √= raporti është i publikuar në ueb-faqe.

9. Përmbushja e premtimeve të fushatës zgjedhore 2009

Gjatë fushatës zgjedhore 2009-2010 kandidati për kryetar komune, tani Kryetari i Komunës z.Shukri Buja, para elektoratit të tij ka prezantuar 20 premtime për sfera të ndryshme. Pas monitorimit të gjitha premtimeve të dala nga fushata zgjedhore, Instituti GAP dhe BIRN, në fund të 2010 i kanë shkruar letër të hapur Kryetarit të Komunës të cilit iu përkujtuan edhe një herë premtimet e dhëna, duke kërkuar njëkohësisht realizueshmërinë e tyre.

Tabela më poshtë vlerëson progresin e arritur në realizueshmërinë e premtimeve të dhëna në 2010. Në këtë tabelë janë përfshirë 20 premtime të dhëna. Në bazë të hulumtimit të GAP del se pas dy viteve të qeverisjes në komunën së Lipjanit, apo gjysmën e mandatit qeverisës, 5 premtime janë përmbushur, 8 nuk janë realizuar, ndërsa në 7 premtim ka pasur nisma dhe rezultate evidente, por nuk mund të konsiderohen premtime të përmbushura:

Premtimet	Realizueshmëria
Investime në infrastrukturë rrugore, kanalizim, ujësjellës dhe në fusha të tjera.	Premtim i realizuar.
Punësimin e rasteve sociale	Premtim i pa realizuar. Nuk ka pasur ndonjë të dhënë që dëshmon angazhimin e kryetarit për t'i punësuar rastet sociale.
Përkrahje ndaj kategorive të dala nga lufta e fundit e UÇK-së	Në përgjithësi ka pasur përkushtim të autoriteteve lokale në këtë drejtim dhe kjo mund të merret si premtim i përmbushur.
Krijimi i hapësirave ku të rinjtë do të mund t'i zhvillojnë aktivitetet sportive dhe kulturore.	Investime në këtë drejtim ka pasur, por kjo nuk ka ndikuar në rritjen e interesimit tek të rinjtë për sferën e sportit e të kulturës.
Digjitalizimi i sektorit të gjendjes civile në komunë.	Ky premtim është realizuar.

Ngrohje qendrore dhe alternative për qytetin e Lipjanit.	Premtim i papërmbyshur.
Ngritja e objekteve të reja shkollore, rritja e cilësisë së mësimin	<p>Sa i përket ndërtimit dhe renovimit të objekteve të shkollave ka pasur progres të konsiderueshëm. Mirëpo qytetarët ankohen se prioritet iu është dhënë vetëm. fshatrave ndërsa qyteti ka mbetur aty ku ka qenë, pa investuar asgjë. Dy shkollat e mesme të qytetit, gjimnazi 'Ulpiana' dhe shkolla profesionale 'Adem Gllavica' kanë mungesa të hapësirave shkollore. Këto dy shkolla shfrytëzojnë një objekt të përbashkët dhe i cili është shumë i vjetër. Nxënësit e këtyre shkollave nuk asnjë kabinet ku mësimin teorik do të finalizonin me atë praktikë. Nxënësit e gjimnazit "Ulpiana" nuk kanë as edhe sallë të edukatës fizike. Ata dikur e kishin një sallë, mirëpo me t'u ndarë objekti i kësaj ne mes gjimnazit dhe shkollës teknike, salla e edukatës fizike iu ka takuar shkollës "Adem Gllavica". Në situatë shumë të rëndë është edhe shkolla fillore 'Vëllezërit Frashëri'. Kjo shkollë në qendër të qytetit është shkolla që asnjëherë nuk është rinovuar. Objekti i saj është shumë i vjetër. Për më shumë kjo shkollë në qendër të qytetit, nuk ka as ngrohje qendrore. Tërë stinën e dimrit nxënësit e kësaj shkolle ngrohen përmes stufave. Krahas ndërtimit të disa objekteve, asnjë nga shkollat në komunën e Lipjanit nuk ka mjek, apo psikolog. Kjo gjë ende ka mbetur vetëm një premtim. Sa i përket suksesit të nxënësve në testin e maturës, ndryshon shumë nga shkollat e qytetit tek ato të fshatit. Përderisa në dy shkolla në qytet kanë kaluar mbi 50% të nxënësve, në fshatra ka ndodhur krejt diçka tjetër.</p>
Shëtitore dhe parqe	<p>Në këtë drejtim kemi lëvizje pozitive në krahasim me vitet e kaluara. Parku i gjelbër përgjatë rrugës 'Gjergj Kastrioti' ka përfunduar plotësisht, dhe me këtë park qyteti ka marr një pamje me të pëlqyer.</p>

Zhvillimin ekonomik sidomos në fushën e bujqësisë	Ka pasur progres evident ne këtë drejtim, por mbështetja me e madhe për bujqit e kësaj ane ka ardhur nga ana e nivelit qendror të institucioneve te Kosovës.
Shpalljen e zonës ne Ribrain e madh në zonë të agrobiznesit	Kjo zonë është shpallur nga komuna si zonë e agrobiznesit, por nuk ka pasur asnjë hap të mëtutjeshëm në promovimin dhe funksionalizimin e kësaj nisme.
Zhvillimin e turizmit	Edhe pse komuna e Lipjanit ka predispozita shumë të mira për zhvillimin e turizmit, nga kuvendi komunal deri në tani asgjë nuk është bërë në këtë drejtim. Në këtë komunë gjenden: Parku nacional i Blinajës, Qyteti antik i Janjeves dhe Shpella e Gadimes. Këto tri pasuri shumë të çmuara për popullin tonë, ende nuk po e gëzojnë respektin e merituar. Që nga pas lufta asgjë nuk është bërë për ruajtjen, mirëmbajtjen apo edhe reklamimin e tyre, as nga ana e qeverisë qendrore apo lokale, në mënyrë që ta zhvillojmë turizmin. Këtu duhet të theksohet se Shpella e Gadimës nuk është në menaxhim të Komunës. Që nga pas lufta këtë shpellë e menaxhon Agjensioni Kosovar për Privatizim. Ky i fundit nuk ka shprehur shume interesim për këtë shpellë, sa që tash e 13 vite që nga pas lufta për shpellë përkujdeset një person fizik që dikur ishte punëtor i kësaj. Ai dhe familja e tij kujdesen për vizitoret, mirëmbajtjen e të gjitha tjerat.
Largimi i kundërmimit të erërave nga ferma e pulave ne Lipjan.	Kjo nuk është realizuar.
Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i qytetit	Pjesërisht i realizuar.

Renovimi i shtëpisë së kulturës si dhe funksionalizimi i jetës kulturore si kinematografi, art skenik.	Shtëpia e Kulturës pjesërisht është rinovuar, por zhvillimi i jetës kulturore është i ngjashëm më periudhën e para zgjedhjeve të 2009. Shfaqjet e dhëna në këtë teatër kryesisht kanë ardhur nga lëvizja skenike e “Teatrit Kombëtar” në Prishtinë dhe shfaqja e fundit e dhënë në teatrin e Lipjanit është ajo e “Sonte jam vetun” me regji të Enver Petrovcit e prezantuar në shkurt të 2011.
Digjitalizimin e bibliotekës së qytetit	Premtim i porealizuar.
Renovimin e stadiumit të qytetit.	Ka pasur nisma në këtë drejtim, por kanë munguar investimet e dukshme në këtë pikë.
Për fshatin Smallushë rregullimi i rrugëve, ndërtimi i një shkolle të re si dhe i një fushe sporti.	Investimet në këtë fshat janë shtrirë në rregullimin e infrastrukturës, por nuk ka pasur nisma për ndërtim të shkollës dhe as të fushës së sportit.
Për fshatin Gadime, ndërtimin e një shkolle të madhe dhe moderne si dhe asfaltimin e gjitha rrugëve të brendshme.	Në Gadime një shkolle fillore është ndërtuar, ndërsa një shkolle tjetër “Zenel Hajdini” është meremetuar. Vlera e këtyre investimeve ka qene afro 300.000 euro. Rrugët përgjithësisht janë asfaltuar.
Krijimin e 5 mijë vendeve të reja të punës	Premtim i porealizuar.
Ndërtimi i dhjetë fabrikave të reja.	Premtim i porealizuar.

Burimet:

1. Kuvendi i Kosovës. Ligji për Vetëqeverisje lokale. - http://kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L040_al.pdf
2. Komuna e Lipjanit. Statuti i Komunës së Lipjanit - <http://kk.rks-gov.net/lipjan/getattachment/Municipality/Statut/Statuti-i-aprovuar,-me-26-09-2008-pdf.pdf.aspx>
3. Zyra e Auditorit të përgjithshëm. Raporti i Auditorit për Komunën e Lipjanit për vitin 2011. - http://www.oag-rks.org/repository/docs/Lipjan_31_12_2011_Final_alb_616502.pdf
4. Komuna e Lipjanit. Raporti i shpenzimeve janar – dhjetor 2010.
5. Komuna e Lipjanit. Raporti i shpenzimeve janar – dhjetor 2011.
6. Komuna e Lipjanit. Raporti i punës së ekzekutivit komunal 2010.
7. Komuna e Lipjanit. Raporti i punës së ekzekutivit komunal 2011.
8. Ueb faqja zyrtare e Komunës së Lipjanit. <http://kk.rks-gov.net/lipjan/Home.aspx>
9. Tabelat e Buxhetit të Qeverisë së Kosovës për vitin 2011. <http://mf.rks-gov.net/sqal/ministriaefinancave/buxhetiirepublikessekosoves/buxhetiendror e.aspx>
10. Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë. Statistikat e Arsimit në Kosovë 2011. Statistikat e arsimit në Kosovë. Burimi: <http://www.masht-gov.net/advCms/documents/11052012.pdf>
11. Raportet vjetore 2010 -2011 të Koomisionit Rregullativ të Prokurimit Publik - http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Home&LID=1&PCID=-1&CtlID=HTMLStatic&CID=PPRCAnnual&PPRCMenu_OpenNode=90
12. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Njoftimet për lidhjen e kontratave përmes prokurimit publik nga Komuna e Lipjanit. - https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=SearchNotices&stat=2&PPRCMenu_OpenNode=114